



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRSEM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANNA	
Sh. U. 01	Nr. Br. 24510
Mr. I faq. 4	Data: 31.07.2024
Br. str. KAMENICË/A	



Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor në fshatin Berivojcë

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimet:

UEBFAQE:

FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=887018356793831&set=pcb.887018570127143>

PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE:

Me 09.07.2024 dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Berivojcë duke filluar nga ora 19:19.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Drejtoresha e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, Burbuqe Leka, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Uran Berisha, Drejtori i Drejtorisë për Investime Kapitale, Blerim Murina, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, banorë të fshatit Berivojcë.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Kam knaqësin të ndaj me juve detajet kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veçant sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi

shum të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojm një draft buxhet për vitin e ardhshëm. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro 5.10% më shumë se në vitin e kaluar, ku pjesa e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumën 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres qe përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishmë në fshatin Berivojcë

Më pasë Zëdhënsja e Komunës, Lidiona Marovca ka prezantuar punët që janë kryer gjatë viti të kaluar: Asfaltimi i gjadës së vjetër në Berivojcë, Topanicë dhe Koretin, është trotuari, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Berivojcë-Koretin, zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në rrugën Gjon Sereqi si dhe në rrugën Kryëziu, mbjellja e drunjëve dekorativ. Përfitues i grantit ka qenë një biznes nga Berivojca, një student ka përfitur bursë studentore.

Kërkesat e banorëve ishin të ndryshme si:

Banori Ilir Tahiri, Kryetar i Këshillit Lokal: Kërkesa e parë ka të bëjë me asfaltimin e rrugës Rexhep Hoti, 100 metra e cila i përfshin mbi 60 shtëpi dhe është nje lidhëse e rrugës Breznica dhe e rrugës Xhevdet Salihu. Pjesa natan lumit ka problem me kanalizim, prej të reshurva në vitin 2021 është mbyll kanalizimi dhe del në sipërfaqe, riparim i kanalizimit. Unë diqka tjetër nuk kam të flasim secili banor me kërkesat e veta.

Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Uran Berisha përgjigjet: rruga Xhevdet Salihu dhe rruga Breznica është e përfshime në proktë që të asfaltohet në këtë vitë. Ndërsa rruga Rexhep Hoti nuk gjendet në gjeoportat dhe e kemi shkru si degzim të rrugës Breznica.

Banori Halil Fejzullahu: me vjen mirë që keni ardhë të i ndëgjoni problemet tona, po filloj prej parkut të fshatit të i marrin shportat e mbeturinave, mirëmbajtja e parkut. Pse buka në Kamenicë shitet 60cent ndërsaa ne vendet tjera shitet 50 cent?

Drejtoresha Burbuqe: unë e kam adresuar shqetësimin e juaj te inpektorati që të dalin në teren me i inpektuar qështjen e qmimeve, dhe kur të marrë përgjigje nga ta do të informoj me detaje.

Banori Ramiz Kryeziu: Derti i komuniteti romë, ne jemi përcjellës i situatave të ndryshme, në fshatin berivojcë më së tepermi investime ka bërë vetem kjo qeverisje. Nga niveli qëndror komunitetet janë shkel më se shumti, duhet me qenë qeverisja lokale me qeverisjen e nivelit qëndror. Ne e kemi bërë një projekt mirëpo i vonshëm, e kemi dorëzuar në komunë kërkesat edhe për rrugicat që duhet të shtrohen. Kërkesa është për rrugica te familja Krasniqi, Aleksa Kostiq, Vllaznim Bashkimi, Savska, vllzërit Maliqi, rrugica te familja Nikoliq, rrugica te familja Islami dhe rrugica te Bajram Bajrami afër lumit. Afërisht 1023m gjatësi. Vazhdimi i rregullimit të proit nga ura e proit deri tek lumi afërisht 30m.

Banori Hazir Ajvazi: Rruga Savska duhet të i rregullohet edhe kanalizimi, si dhe ujësjellësi nuk është e rregulluar mirë.

Drejtori Uran Berisha përgjigjet: në këto rrugët që i mer komuna me intervenu me i rregullu në atë vendë që nuk ka kanalizim ose është kanalizimi i vjetër aty intervenojmë e rregullojmë, gjithashtu vlen edhe për shtrirjen e rrejtit të ujit të pijes.

Banori Gzim Kastrati: na dhe tri familjet kemi nevoj për kanalizim dhe asfaltim 200 deri 250 metra, rruga thirret rruga e Arave, përballë lagjes së konakut.

Banori Ramë Bucolli: kamë bërë një kërkes për rrugën që të shtrohet me zhavor, si dhe ndriqim publik tri dritat, vazhdim i rrugës Maliqi, afërsisht 200 metra. Si dhe ujësjellës nuk kemi, kanalizimi është privat si dhe rregullimi i saj.

Banori: Rruga Savska, asfaltim dhe kalanalizim

Banori Adil Leka: rruga Mujo Ulqinaku, duhet të rregullohet kanalizimi dhe ujësjellësi. Deponi ilegale të hiqet dhe të vendosen Kamerat te lumi i fshatit.

Banori Ramiz: në rrugicat që i përmenda kërkoj edhe të vendoset ndriqimi publik, rruga e Kaqakëve të vendoset edhe një trotuar.

Banori halil: gjysma e poqeve elektrike nuk funksionojn, kërkoj nga komuna që të bëhet rregullimi i poqave elektrik.

	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Ilir Tahiri	Riparimi i kanalizimit.	Me telefon
2.	Halil Fejzullahu	Mirëmbajtja e parkut, dhe heqjen e bërllodgeve të rregullta nga shportat park. Vendosja e poqeve elektrike të reja.	Me telefon
3.	Ramiz Kryeziu	Asfaltimi i rrugicave te Familja Krasniqi, Aleksa Kostiq, Vllaznim Bashkimi, Savska, vllazërit Maliqi, rrugica te familja Nikoliq, familja Islami dhe rrugica te Bajram Bajrami afër lumit. Afërsisht 1023m gjatësi, si dhe shtritja e ndriqimit publik, Vazhdimi i rregullimit të proit nga ura e proit deri tek lumi, 30m gjatësi, Rregullimi i trotuarit rruga e Kaqakëve.	Me telefon
4.	Hazir Ajvazi	Shtrirja e rrejtit të ujrave të zeza dhe ujësjellësit, rruga Savska.	Me telefon
5.	Gzim Kastrati	Rruga e Arave- asfaltim dhe rregullimi i kanalizimit, 200-250m.	Me telefon


6.	Ramë Bucolli	Rruga Maliqi shtritja me zhavor dhe ndriqimi publik, ujësjellësi dhe kanalizimi, 200 metra gjatësi.	Me telefon
7.	Ilmi Rexhepi	Asfaltim i rrugës Savska, rregullimi i kanalizimit.	Me telefon
8.	Adil Leka	Kanalizimi dhe ujësjellësi rruga Mujo Ulqinaku, Heqja e deponisë ilegale rruga e Moqares, Vendosija e kamerave të Lumi.	Me telefon

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 20:20.

Procesmbajtëse:

Samire Krasniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor në fshatin Berivojë

Data: 09.07.2024

Ora: 19:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatësia etnike	Nënshkrimi ¹²
1.	SAMIR RAMABAJA	045266984		M	KOSOVAR	
2.	GEZIM KASTORATI	045372832		M	KOSOVAR	
3.	Ilir Tokri	044-715-677		M	Kosovarë	
4.	Huki Meni	044-603121		M	Kosovarë	
5.	Maed Shij	—		M	Sh	
6.	ELMIR KURTESHI	047-154586		M		
7.	ARRIM ZHURA	049-610938		M		
8.	NAZIM KRANO	044632411		M	KSHIPTAR	
9.	ALI SHABAN	049 20866		M	SHIPTAR	
10.	ENVER MEHMETI	044231147		M	SHIPTAR KOSOVAR	
11.	HAZIR AJVARAJ	044702116		M	SHIPTAR KOSOVAR	
12.	ADIL ZEKRI	044730477		M	KOSOVAR	
13.	Halil Fejzullahu	044401634		M	Kosovar	
14.	Folun KONGOL			M	S SH	
15.	Ramëban	044-712-315		M	Shqiptar	
16.	Saniz KRTEJ	044-315-229		M	ROM	

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. **SRB:** Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografiše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpunoj të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. **SRB:** Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.